

Carla Del Ponte: Jam gati për një mision të ri

06/04/2011 - 16:47 | Vjosa Gërvalla



© albinfo.ch

Nën një stuhi duartrokitjesh, znj. Karla Del Ponte, ish-prokurore e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, takoi publikun e saj të etur për ta dëgjuar.

Ky takimi u organizua nga Southeast European Prospects Integrim (SEPI) në partneritet me Teatrin e Komedisë të Gjenevës si dhe me mbështetjen e Këshillit të kantonit të Gjenevës.

"Kjo zonjë e lirë, e pavarur dhe e pakompromis", si e tillë e prezantuar nga organizatorët, mbushi sallën plot të hënën në mbrëmje. Dhjetëra studentë, nxënës, mësues si dhe personalitete politike dhe qeveritare të Gjenevës i bënë një pritje në shenjë respekti dhe mirënjohjeje. Krahas personaliteteve të njohura të Kantonit të Gjenevës, ishin po ashtu shumë shoqata dhe përfaqësues të komunitetit boshnjak, ndërsa shqiptarët, duke përfshirë edhe gazetarët, shkëlqenin me mungesën e tyre.



©albinfo.ch

Anne Bisang, drejtoreshë e Komedisë së Gjenevës, mirëpriti Carla del Ponten, duke thënë se ajo është "një figurë emblematike e drejtësisë që simbolizon për ne të gjithë një vendosmëri të përsosur në luftën e mbrojtjes së dinjitetit të njerëzve të shkelur". Drejtoresha shprehu respektin e saj për një grua të shquar, e cila me forcën e bindjes së saj si dhe me ashpërsinë e saj intelektuale mundëson të "besojmë në një shoqëri humane të përmirësueshme, më të drejtë, më të sigurt, të shëndetshme, më pak arbitrare si dhe më pak të dhimbshme".

Fjalimet për të ftuarën vazhduan me ndërhyrjen e zonjës Sandrine Salerno, kryetare e qytetit të Gjenevës, si dhe të Charles Beer, udhëheqës i Departamentit të shkollimit publik (DIP). Që të dytë theksuan rëndësinë e këtij debati.

Biseda e realizuar nga Christophe Solioz, sekretar i përgjithshëm i qendrës Europiane Integrition Strategies, i dha rastin zonjës Del Ponte të shprehet drejtpërdrejt para publikut të saj.

Pas tre vjet heshtjeje, pjesëmarrësit e shumë patën më në fund rastin të dëgjojnë autoren e librit grushtdhënës me titullin "Ndjekja, kriminelët e luftës dhe unë". Në sytë vigjilent të të ftuarve, zonja Carla del Ponte pranoi lojën e kartolinave, të cilat përmbanin momentet kryesore të karrierës saj dhe që njëkohësisht shënonin historinë e drejtësisë universale dhe të drejtave të njeriut.

Nën ritmin e rastit, duke nxjerrë një kartolinë pas tjetrës, zonja Del Pont përmendi çastet e dhimbshme të gjenocidit në Ruandë, takimin e saj me presidentin Kigali, anekdotat e ndryshme në Sicili, shkëmbimet me gjyqtarin antimafioz Falcone, nga i cili ka mësuar shumëçka, dhe posaçërisht takimin me treqind nënat e Srebrenicës më 1999.

Në veçanti, gjatë tërë mbrëmjes ajo theksoi ngadalësinë e drejtësisë dhe të proceseve. Me një zë ironik dhe kritik ajo shpjegoi se si "Këshilli i Sigurimit mund të tregohet shumë i lidhur me detaje siç jështë vendi i një presje në fjali, kurse çështjet e rëndësishme dhe urgjente prisnin".

Megjithatë, ajo vuri në pah faktin se Tribunali ad hoc i Ruandës si dhe ai i ish-Jugosllavisë çuan në krijimin e Gjykatës së Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare, një hap i madh për drejtësinë. "Kjo i bëri të mundshme që zyrtarë politikanë dhe ushtarakë të paraqiten përballë drejtësisë. Prej 161 personave, vetëm edhe dy kanë mbetur pa u ndaluar", nënvizoi ish-prokuroerja e Tribunalit të Hagës.

Duke iu përgjigjur z. Solioz, zonja Del Ponte pohoi se në këtë libër ajo kishte për qëllim të nxjerrë në pah pengesat dhe vështirësitë me të cilat ajo është ballafaquar gjatë funksionit të saj si prokurore.

Duke përmendur pikat kryesore të karrierës së saj, ish-prokuroerja përsëriti vazhdimisht se kur kemi të bëjmë me punët e drejtësisë, mund të jem e urryer nga vetë ata njerëz që dikur na kanë lavdëruar. Si shembull, përmendi rastin e Ruandës dhe të nënave të Srebrenicës, prandaj "ky zanat kërkon supe të palëkundshme".

Sa për projektet e saj, shumë shpejt ajo tha se ishte mirë që ishte e gatshme të sjellë ndihmën e saj sa i përket çështjes së trafikimit të organeve të raportuar nga Dick Marty. Zonja Del Ponte rikujtoi faktin se kishte filluar në Kosovë punën e saj dhe mendon të jetë "personi i duhur si dhe më i aftë për të udhëhequr hetimet në fjalë". Por, shton ajo, "deri tani nuk kam marrë asnjë kërkesë, sepse siç jeni në dijeni, në këtë rast vullneti politik është i domosdoshëm". Sipas saj, ajo është pengesë për çështje të tilla, sepse "ky do të shkaktonte sërish çrregullime, në veçanti në kohën kur Kosova nuk është në situatën e saj më të mirë".

Prezantimi i momenteve kryesore të karrierës së saj janë mbresëlënëse, edhe pse, me keqardhje, vërehet se në asnjë moment të mbrëmjes z. Del Ponte nuk i përmendi vuajtjet e popullsisë civile të Kosovës.

Vështrimet e saj për çështjen e raportit të Dick Marty-të, deklaratat e ish-zëdhënëses saj, Florence Hartman, si dhe polemikat e shkaktuara nga libri saj i fundit do të kishin hedhur më shumë dritë për çështjen tonë. Por, ja që atë natë vetëm ata që figuronin në listën e organizatorëve patën të drejtë të shtrojnë pyetje.

